

8JH-1
R 22

ALBERT RAKIPI

M.

**DITA
KAN
EMRIN
TEND
POEZI**

814474
R 22

ALBERT RAKIPI

LIBRARY
OLAC LIBRARY

DITA
KA
EMRIZ
TËND
poezi



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

Nënët e dëshmorëve

Ikin vitet dhe ju,
të mirat nëna të dëshmorëve,
rralloheni në podiumet e kuq
të 5 majeve,
të nëntorëve,

Po na ikni...

Ju kërkojnë nipër e mbesa.
Si t'u themi?... Ah, po. Ikën te partizanët.
Partizanëve t'u çojnë bukë,
një palë çorape të leshta.

Ju kërkojnë gazetarë e telekronistë,
ju thërrasin shtëpive.

S'ju gjejnë.
Po kurri fjala juaj s'ka munguar në gazetë,
as zëri e syri në kronikat televizive.

Nënë e deshmorëve

Po na ikni...

Po si ndodhka kështu, moj të shtronjtë?!
Ju ikni...

e ne na duket e vërtetë
ajo që fëmijëve u thamë:
Kanë shkuar te partizanët
e prapë do kthehen...

Barrikada

E ngritën barrikadën
me gurë nga gurët e rrugicës sonë,
me karrocën e drunjtë të hamallit të varfër,
me këngën e lirisë që na ziente në gjokse...
Ç'të vinim në barrikadë tjetër?
Erdhi dhe një murator
dhe supeve të saj hodhi pallton e vjetër...

Zogu i marsit

Vinte gjithmonë një zog i bukur
pranverës në strehën e shtëpisë.
Nga hapësira të kaltra ai zog këngëshumë
fluturonte e më ulej në sup të fëmijërisë.

Ditëve të para të mësrit çdo vit
me dy-tri cicërima thoshte: Erdha!
E pas më ndiqte gjer në vjeshtë
kur ai nisej në shtegtime të reja.

Vinte në mars e ikte në vjeshtë
zogu i bukur i fëmijërisë sime.
Po unë e kërkoja në çdo stinë,
pas të më ndiqte në shtegtime.

Nuk di në ç'mars, në çfarë dite
erdhi e s'iku kurrë.
E pas më ndjek në hapësira drite
ky zog punëtor e këngëshumë.

Me mua është kur plugoj arën,
tokës së vlagët i gëzohet si unë.
Me mua është kur takoj të dashurën,
në rrugë të njohura a të pashkelura kurrë.

Është një zog i bukur në jetë,
zogu i èndrrës emri i tij.
Është një zog që s'njeh vjeshtë.
Foleja e tij — te zemra jote, njeri!

Në autobusin e orës gjashtë

Në autobusin e orës gjashtë,
hipën minatorët e turnit të parë,
gjimnazistët e zhurmshëm me çanta në duar,
një grua pak e trishtuar me fëmijën në krahë,
një çift pleqsh që vështronin si dy të

dashuruar

dhe agronomi i sektorit të parë
që shkon të marrë teserën e kandidatit.

Në urbanin e orës gjashtë
pret të hipë edhe një njeri.

Në sy — një buzëqeshje tinzare,
në duar — njëzet copë fshesë.

(Ç'të bëjmë, vëllaçko, për të nxjerrë ndonjë

lek!)

Mos e merr këtë njeri, shofer!

Se minatorët do ta ndiejnë lodhjen dyfish
dhe gjimnazistët s'do të përqendrohen dot mbi
libra,

dhe kjo grua që çon fëmijën në spital
më shumë do të trishtohet, do t'i shtohet
dhimbja,
pleqtë gazmorë do të bëhen grindavecë,
fjalamanë
dhe agronomi gjëzimin do ta ketë më të paktë!
Mos e merr këtë njeri, shofer!
Dita më e lodhshme do të jetë për ty,
timonin më të rëndë do ta kesh.
Mos e merr...
Në autobusin e orës gjashtë
hipën minatorë e gjimnazistë,
dhe pleqtë gazmorë, dhe agronomi i ri,
dhe fëmija i sëmurë, dhe gruaja pak e trishtë,
dhe mëngjesi i bukur i majit... dhe asnjeri!

Demetra¹⁾

Nuk di se ç'pamje ke pasur, Demetra,
në përfytyrimin e njerëzve te grekët e vjetër.
S'kam si ta di, por them se te kujtesa
e mijëvjeçarëve që ikën e bukur ke qenë
patjetër!

Ti ishe perëndeshë, (ti ishe një mit)
që rriteshe e zbukuroheshe në çdo brez të ri.
Po koha ime nga mijëvjeçarët të nxori,
të dha gjak edhe zemër, të bëri njeri!

Nuk di kush të thirri i pari Demetra,
«perëndeshë» kush të quajti në lashtësi;
di që koha ime tha: «Demetra është zemra,
thuaji zemrës ta lulëzojë tokën, njeri!»

1) Demetra — hyjneshë e tokës

Dita ka emrin tënd

Fjalët që thoshe ti, e drujtura,
gjithmonë më kanë kumbuar në shpirt.
Po sot krejt ndryshe më ndodhka,
në çdo hap ato më janë muzikë.

U bë muzg. Zbriti mbrëmja e praruar.
Në zemër më rreh fjala «po» si ëndërr.
Ç'ditë është vallë? E kam harruar.
Dita e sotme ka emrin tënd.

Meditim në ditën e 8 Nëntorit

Rri e mendoj sot shpirttrazuar:
Ku fillon dashuria ime për ty, ku?

Të kam ndier
në belbëzimin e parë, në hapin e parë,
por dot emrin s'ta kam thënë.

Të kam takuar sërish!
Ti i gjelbëroje pyjet
dhe zogjtë i krijoje ti
të lozte fëmijëria ime.
Të kam takuar, të kam takuar...
Njëzet e pesë vjet.

U rrita.
Njëzet e pesë vjet.
U rrit dashuria, s'u shua malli.
Njëzet e pesë vjet ti
sy drithë në çdo udhë që shkela së pari.

Sib e A

Po ku fillon dashuria ime për ty, ku?

Rri e mendoj shpirttrazuar.

Përderisa s'qenka një çast, s'qenka një ditë,
them se ajo zë fill në gjakun tim...

A e di?

A e di, e dashura ime?

Fjalët pér ty i kam bérë këngë
e këngët zogjve ua kam mësuar
që tē tē këndoijnë mëngjeseve e mbrëmjeve.

A e di, e dashura ime?

Mallin pér ty e kam bérë erë
e erën pemëve e gjetheve ua kam dhënë,
ndaj kur kalon ti ato fëshfërijnë.

A e di, e dashura ime?

Në çdo udhë kam mbjellë lule
që gonxhe çelin çdo mëngjes tē ri.
Këputi se janë pér ty!

A e di, e dashura ime?

Me sytë e mi

u kam thënë njerëzve të mirë gjithçka
ndaj të përshëndesin ty.

A e di, e dashura ime?...

Patjetër që e di,

përderisa zogj të bukur në dritare të vijnë,
përderisa plepa e blirë në rrugë zhurmojnë,
përderisa në çdo hap këpus një karafil,
përderisa kaq shumë njerëz të ngjatjetojnë...

Pylli mat moshën time

Shkoj në pyll.

Kam qeshjen e drojtjen e një fëmije,
dhe sytë e një njëzetvjeçari të dashuruar,
dhe zemrën e madhe të një babai të mirë.

Shkoj në pyll...

Më dhemb fleta që bie lehtë lehtë
dhe pahja e lashtë e tharë në degë.

Dëgjoj hapat e mia

dhe hapat e zogjve në lisa.

U flas lisave të moçëm

dhe luleve të brishta...

Shkoj në pyll

dhe pylli mat moshën time...

Memeja

Memeja vdiq.

Prapë në shtëpi të saj
vijnë fëmijët e mëhallës sime;
harrojnë
e te porta thërrasin: Meme! Meme!
Dhe gjyshja ime
(e vëtmja plakë në mëhallë)
grindet me të gjithë në shtëpi
dhe kafen e mbasdites në dy filxhanë
e shtie dhe pret... Memenë të vijë...

Memeja iku...

Mungesë e saj
e përjetshme na duket.
Por ky është vetëm një çast,
se nëpër dhomë vërtitet
hutimi i Orgesit trevjeçar
dhe rrugët e kërkojnë Memenë...

E pamundur!

Thirra emrin tënd
dhe prita ashtu si dikur
te të dëgjoja zërin... E pamundur!

U fola pemëve rrugës duke ikur,
fletëve që binin dhe fushës në skaj
zërin tënd të më sillnin... E pamundur!

Thirra një ditë maji të qeshur
për të ribërë buzëqeshjen tënde dhe prita
sytë e tu të më flisnin... E pamundur!

Pastaj kujtesës i thirra shpresëhumbur
për të rikrijuar portrëtin tënd,
fjalët, mendimet... E pamundur!

Atëherë besova se s'të kisha njohur kurrë,
një çast, vetëm një çast dhe qesha me veten:
(Përpara kisha letrën tënde!) E pamundur!

Letra jote ardhur nga një fshat i jugut
ku të rrethokan 'njerëz «të mërzitshëm»,
«pa kulturë»
dhe ditë gjithmonë «monotone»...
E pamundur!

E dashur! Në qëntë letra që më ke dërguar
një pjesë e shpirtit që s'ta paskam njojur,
të më duash ti, të të dua unë... E pamundur!

Reportazh nga festa e bukës së re

Në mëngjesin e qelqtë të verës
buzë arës së korru, nën plepat e butë ~~toj~~
pa altoparlantë të zhurmishëm, pa podium,
me një banderolë vetëtitëse, dy tre flamuj
nisi festa e bukës.

Fare thjesht,
pa tingujt e orkestrës së bandës,
pa bujë,
vetëm me një fizarmonikë, një klarinetë
që djemtë i ngriti në një kolonjare të shpejtë...
Pastaj ca çaste qetësi.

Flet sekretari: të përparuarit, ndarje
flamujsht...

Gëzuar!

Në çast vajzat u bënë njëqindfish të bukurë,
dhe nëna ime pák e kërrusur në shtat,
dhe gratë e tjera të fshatit po aq,
në çast u bënë vajza të bukurë, shtatselvi.
Vetëm toka me thjeshtësinë e nënave
heshtte përkarshi...

E diel vjeshte në Tiranë

Të gjithë trenat i kam nisur sot për në vendlindje
Mos më pyësni ç'sekret u kam thënë makinistëve,
ç'përralla të magjishme u kam treguar fëmijëve,
për ç'dashuri u kam folur njëzetvjeçarëve,
ç'mall u kam zgjuar nënave e gjyshërve.

Të gjithë zogjtë sot i kam nisur për aty!
Mos më pyesni për ç'hapësira të kaltra u kam folur,
për ç'shpate malesh, për ç'pemë të çelura!

Me një shami të bardhë lidhur në krahë
Për në jug, për në vendlindje...
Mos më pyesni ç'nuse do të udhëtojnë me to.
ato janë të gjitha të bukura!

Për në jug, për në verilindje
Retë vjeshtore, mendimet e mia
dhe kjo e diel vjeshte në Tiranë...

Më falni, shokë e miq, e ju të porsanjohur,
nëse s'u ula një kafe të pi ja me ju,
zemra si një zog fluturoi në vendlindje...

Kur përcillem me nënën

Ja nëna,
si e huaj hyn e del në shtëpi;
më puth, më vështron pa thënë një fjalë.
Pas më vjen, më ndjek, ulet diku,
pastaj më ndjekin sytë e saj
udhëve në çdo hap.

Lotët e nxeh të që i bien në pëqi
zogj bëhen papritur e më futen në gji.
Zemrën ma ngrohin me ca fjalë malli,
ata më vënë në gjumë e më zgjojnë çdo
mëngjes

me ca fjalë të dashura si një ninullë,
me ca ledhatime të ëmbla si një diell vere.

Ata më vënë në udhë
me ca këngë të bukra të padëgjuara kurrë...
E di mirë!

Pa këta zogj zemrën do ta kisha shkretëtirë...

E sinqertë

Për shkak të syve që të janë zmadhuar pak,
aq sa për të qenë më të bukur, më të çiltër...
Për shkak të flokëve zbukuruar në permanent,
aq sa zbukuron prilli pemët në pranverë...

Për shkak të të kuqit të buzëve, fare të lehtë,
aq sa përflek dielli qershítë në degë...

... Pra për të gjitha këto

dhe për shkak të shkujdesjes së fjalës
me të cilën më flet, më përshëndet

e paskam një dridhje të lehtë, fare të lehtë
që mundohem të mos e kem ose të paktën ta
fsheh...

... Dhe ti bën sikur s'e vë re...

Kujtimi

Ikën ca stinë, prapë erdhi vjeshta
dhe prapë m'u kujtove ti.
Një portë s'e hap lehtë te zemra
njeriu. Ikën e s'kthehet përsëri.

Një vajzë m'u ngatërrua në ditët e mia;
në vjeshtë, kaq thjesht, kaq çiltër.
Ndodhte shpesh dhe në ëndërr ta shihja
e ditët m'i zgjonte veç një dëshirë:

Ta shihja të rendte, çapkënçe të qeshte,
siç dintë të qeshte vetëm ajo.
Kaç herë kam menduar vallë ç'të ishte,
dashuri apo... ç'të ishte kjo??!

Nuk di ç'të them, nuk di tani,
pas kaq stinësh rri e mendoj.

Tek zemra një portë s'e hape dot ti,
apo s'munda unë rrugën të t'regoj??!

Kanë ikur vite, kanë ikur vjeshta,
asnje letër, asnje foto s'kam prej teje,
veç sytë e tu 20-vjeçarë i ka ruajtur kujtesa.
Kërrkujt s'ia kam treguar ata si trofe.

Ikën ca stinë, prapë erdhi vjeshta
dhe prapë m'u kujtove ti...

Dy ditë nga mungesa e nënës

Nëna iku në spital.

Dy ditë ka;

orët s'ecin.

Dy mëngjese,

të parat kafe shqeto të babait

i përlotën motrës sytë.

Dy mesdita,

fjalët e saj: «Clodhuni bij!»

vërtiten mundimshëm nëpër shtëpi.

Nënë! Nënë!

Nesër është pranverë,

sot lyem shtëpinë, në muret e bardha

dita vari portretin tënd të qeshur...

Dhe unë përsëri qava fshehur...

Dy ditë... nga mungesa e nënës...
Nga portreti i shtëpisë
askush nga ne s'mundet
të fshijë pezhishkën e mërzisë...

Kur ndahem prej teje

Ka një qind vjet që s'të kam takuar.

S'të· kam folur,

s'të kam thënë: «Të dua!»

(Oh, sa shumë të dua!)

Dhe ti s'më ke pyetur: «Sa?»

Dhe unë si një fëmijë s'të jam betuar:

«Sa një fushë, sa një mal, sa një det!»

(Qso sa tē giitha sē bashku)

(Use sa te gjitha
Ka niëqind viet.

Ka njëqind vjet.
Ka njëqind vjet që s't'i kam pârë sytë,

Ka hjeqlinha vjet qe s' ti kam p, , , , ,
s' tø kam thønø pør ta se i ke tø bukur

s'te kam thene per
dha s't'i kam puthur

dhe st'i kam putnur
ll-a-ti c'ko geshur hareshém: «Värtet?»

dhe ti ske qeshur nareshem. Werter...
Dhe ünnerlich s'te kam thënë se ke s

Dhe unë sërish s'te kam thene se kës^{sy}
të bukur,

te Sakur,
Kittilawu puthur

s̄erish s̄t'i kam puthur.

Ka njëqind vjet...

Ka njëqind vjet mall, e dashur,

që nga çasti kur ndahem prej teje

derisa tē takoj prapë...

Një shekull dëshmor

Më 29 Nëntor u rrethuan katër partizanë
dhe të katër pranë njëri-tjetrit ranë!

15 pranverat e të parit u drodhën si burbuqe
dhe çelen mbi trupin e tij vetëm lule të kuqe.

20 pranverat e të dytit përnjëherësh ranë
si një dorë kallzash prerë nga drapri i parë.

25 vjeshtat e të tretit si lisa u drodhën
prej dhimbjes zogjtë horizontet morën.

40 dimrat e të katërtit në gjoks morën plagë
dhe tokën e ngrohën me gjakun e valë.

Katër partizanë ranë ditën e lirisë
mosha e të gjithëve një shekull ish.

Liria që hapte shekullin e ri
edhe një shekull dëshmor mbante në gji...

Nesër nisem për në jug

U ndava shokëve një grusht arra,
që m'i pat dhënë nëna një vjeshtë më parë.
Arrat krisën në duart e tyre,
në qenien time
krisi malli.
Në pëlhirën blu të mbrëmjes
një dritare u hap kanat më kanat.
Mbështetur në parvazin e saj,
ndjeva jugën që m'u derdh në gjoks, në krahë:
Vjeshta ka ardhur prapë,
nëna është thinjur pak,
motra do të veshë fustan të bardhë,
Orgesi i vogël — një klasë më lart.
Ajo flokëkaçurrelja sybukur pret t'i thuash
atë që një vjeshtë më parë s'ia the dot...
Duhet të vish, duhet patjetër!
Frynte juga, juga më thosh...

Vizitë e nxënësve të klasës së parë në varrezat e dëshmorëve

Ja ku hyjnë.

Seriozë.

Në duart e vockla —
tufa trëndafilash.

Mbi mermerin e bardhë
ca çaste u përkulen
e puthën yjet, emrat e të rënëve
sikur t'u puthnin sytë.

Pastaj gjetën
dëshmorët e fshatit:
Skënderi rri pranë Skënderit,
Shanikoja rri pranë Shanikos.
Pranë një dëshmori rri secili!

Vetëm një vogëlush mbeti vetëm.
Iu ujësuani sytë
e lotët iu këputën çurgë prej tyre
e mbi trëndafila ranë.
Ç'dhimbje!
Emrin e tij
asnë partizan te varri s'e ka!

Po erdhi lulishtari plak
te varri i partizanit të panjohur
vogëlushin e çoi për dore:
«Ky partizani këtu ka emrin tënd!»
E syve të vogëlushit sikur ulet dielli.
Tinës lulishtari fshiu një lot.
Dëshmori dhe fëmija
emrin e njëri-tjetrit morën sot!

Prag vere

Të pangjashme janë
ditët e bukura të pranverës.
Të gjitha një trill maji e kanë.
Nisem herët për në punë,
s'kam kohë të rri para pasqyrës.
Krihem te sytë e shokëve,
zbukurohem te fytyrat e tyre.
Këmisha që preva dje
sot më rri më bukur në trup.
Shokët janë po ata që kisha.
Të tjerët, ata që u miqësova sot,
i kam njojur njëzet e pesë vjet më parë.
Dal në rrugë,
autobusi i orës dy
krejt i ri më duket, si i porsadalë nga uzina,
megjithëse kam udhëtuar me të shumë herë.
Dhe gjimnazistet që zbresin, të qeshura,
me sandale të bukura, me jaka të bardha

kanë një shekull që zbukurohen për këtë
pragverë.

Ditët e pragverës, të shpejta, të shpejta,
të gjitha ikin si një imazh.

Në zyrën e vogël të PT-së në fshat

Kush postoi një letër,
kush nisi një telegram
në zyrën e vogël të PT-së në fshat;
kush bisedon në telefon
në kabinën e vetme të saj...
Asnjërin prej tyre s'e fiksoi kujtesa
megjithëse i njeh të gjithë,
të gjithëve ua di emrat.
Në zyrën e vogël të PT-së në fshat,
në kabinën e vetme në skaj
hynë pak njerëz, fare pak,
por s'më kujtohet asnjëri prej tyre, i harrova.
I harron,
njerëz të zakonshëm, të njojur të gjithë,
veç një grua plakë që bëri këtë telegram
për djalin e saj me punë në Tiranë:

«U bëfsh dhe njëqind vjeç, lajmëro
shëndetin!»

Në zyrën e vogël të PT-së në fshat
sytë e saj
ishin të vetmit sy që dhembnin
(Eh, si s'më shkrove, mor bir, dy gisht
kartë?!)

Dhe njëherazi qeshnin,
se nëna gjithmonë di të falë.
Në zyrën e vogël të PT-së në fshat
sytë e një nëne dhembnin, qeshnin
dhe duart e reshkura që i dridheshin
nisnin për djalin një urim... dhe një shuplakë!

Moshatarja

Stathica Papakristos,
rënë më 28 Nëntor 1944!

U rashë pëllëmbë për pëllëmbë
udhëve të vendlindjes sate.

Ku je ti?

Gurët e kalldrëmeve,
rrugicave të Postenanit, më thanë
se apo kishin ndier hapin tënd të lehtë.
zërin tënd e kish dëgjuar bajamja plakë.
Dritaret e të gjitha shtëpive
sytë e tu kishin parë.

Ku je ti?

Stathica, moj vërsnikja ime,
si ndodhi, moj, kështu?!!
Vërsnike me nënën time ti...

Liria
vërsnikë na bëri të dy.

Dhe unë të kërkoj,
të kërkoj,
të kërkoj,
se nesër kemi festën e lirisë...

Të ka parë në ëndërr nëna

Në fshatin tim në jug,

në shtëpinë time ke ardhur.

Fshehtësish, askush s'të ka parë.

Erdhe butë, portën e shtëpisë hape.

As rrugicat, as oborri s'i kanë ndier hapat e tu,

as dorezat e derës prekjen tënde të lehtë.

Vetëm lulet që ka mbjellë nëna janë zgjuar nga kontakti me erën tënde të mirë.

Pastaj ke shkelur butësisht në dhomat e shtëpisë sime,

në qilimat e bukur që i ka qëndisur nëna.

Askush s'të ka parë,

si një shtojzovalle, si në përralla,

magjishëm ke hyrë e ke dalë,

veç në sytë e nënës portretin tënd ke lënë.

E dashur!

Para meje

ke rrojtur në imazhin e nënës!

Këngë dashurie për vendlindjen

Barrmashit ku kam lindur

Ta kam dashur atë lumin e vogël,
që zbret nga malet e tua të serta.

Ta kam dashur, se ai fëmijérinë time ka marrë
përdore,
fëmijérinë time e ka mësuar të ecë
brigjeve të tij zbukuruar me luleshqerra,
me këngën e zogjve dhe meloditë e erërave.

Ta kam dashur tokën tënde të paktë,
ta kam dashur se në vlagimet e saj
kam takuar duart e stërgjyshërve të mi,
në fushën tënde të paktë
lulëzuar dhe me djersën time tanë.

T'i kam dashur këngët e legjendat e tua
dhe ato kanë rrëmbyer shpirtin tim.

T'i kam dashur dhe ato kanë qenë të parat
libra
ku të kam lexuar historinë.

Ta dua ditën, vendlindja ime,
që bie mbi lumin dhe brigjet e tij,
mbi fushën flori e rrugët e tua.
Ta dua
ditën që bëhet këngë
prej djersës së ndershme të njerëzve!
Vendlindja ime,
dashuria ime!

Gjyshja ime mbjell borzilok

Është koha kur gjyshja ikën tek Memeja,
plaka që kishim në mëhallë.
Po Memeja vdiq dje... Memeja!
Tani gjyshja përgjon hapat e saj.

Pastaj del në oborr.
Te mëllagat këput një gjeth të tharë.
Merr një bel, nxitimthi nis të gërmojë.
Në krahët e saj të vegjël, hollakë
beli më duket tepër i madh.
Ka hutesën e një vajze gjashtëvjeçare.
Nxjerr nga fustani një dorë borzilok
në një saksi e mbjell me merak.
(Moj gjyshe!
Ne lulet i mbjellim në mars,
tani është janar!)
E qesh me vete e bëj t'i flas.

Por më ndalojnë
duart që i dridhen mbi saksi
dhe... hutesa e pamasë.

Më iku vera pa një varg të ri

Më iku vera, s'di se si...

Nuk shkova në fshat si çdo vit tjetër,
ditët një nga një ikën plot limonti,
shokëve s'u shkrova asnjë letër.

Harrova të zemërohesha, të qeshja harrova.
Kisha tri ftesa, një për ditëlindje e dy për
dasma

dhe në asnjérën s'shkova.

Më iku vera, asnjë ditë të saj
s'e sjell dot ndërmend tani.

Harrova vetveten, gjithçka e kundërshtova pa
shkak.

Dhe s'di sa do të kish vazhduar kështu.

Po shokët më dërguan përsëri letra e libra të
rinj,

pastaj erdhën vetë e më takuan të gjithë.

Po vera më iku pa një varg të ri...

Inspektori

Në klasë hyri ai,
me hap të rëndë, i vrenjtur.
Kokën i tundi mësuesit
dhe nxënësit heshtën të drojtur.

Mësuesi, dikur i ri
mësonëtë nxënësit e parë.
Dhe këtij burri — inspektor tani,
atëherë i mësonte «A-në»

Këtij burri që shkruan e shkruan
në një bllok të madh, të ri
e t'i flasë mësuesit të tij,
t'i flasë e paska bezdi.

Fillojmë, — tha mësuesi. — Sot
do tē mësojmë tē fundit germë.
E mësuesi thoshte ZH-ëë,
e nxënësit bënin ZH-ë-ZH-ë.

Pse tē ngeli stilografi, pse,
dhe kokén e ule, inspektor?
Shumë vite më parë këtë germë
s'e shkruaje e s'e thoshje dot.

E mësuesi lodhej e ngjirej
me ty, inspektor, që tanë
ke rënë në dilemë dhe pyet
pse ZH-ja ardhka pas germës I?!!

Vazhdojmë, tha mësuesi qetë,
ja kjo është germa ZH-ë
e klasa zhurmonte ZH-ë, ZH-ë,
e inspektori bënte ZH-ë, ZH-ë.

Ikën prej meje një fëmijë...

Ikën prej meje një fëmijë
brigjeve të një lumi këmbëzbathur;
flet me lumin, me gurët, me drurët
zogjtë e stinës thërret me një fërshëllimë...

Ikën prej meje një fëmijë
me një çantë shkolle hedhur krahëqafë,
me lulet e breglumit mbledhur tufë.
Me të ecën dhe lumi, dhe juga,
dhe zogjtë që e pyesin: Ku ikën, ku?

Ikën prej meje një fëmijë.
Ikën... e dikur s'është më fëmijë
dhe lumi habitet me shtatin e tij,
habitën dhe zogjtë — miqtë e tij.

Ikën prej meje...

Në një fshat të jugut mbjell e korr grurë.

Gëzuar prej ditëve, prej tokës gëzuar!

Ikën prej meje një fëmijë,

për t'u kthyer tek unë i burrëuar.

Ikën prej meje gjithmonë një fëmijë...

A t d h e u

Kam marrë imazhin tënd, vendlindja ime,
(imazhin tënd që bie erë juge)
e në vise të tjera kam ikur.

Sërish jam parë në rrjedhën e një lumi,
sërish më është dukur vetja i bukur.

Kam marrë zërin tënd si jehonë,
(zëri yt ninullë për fushën dhe njerëzit e saj)
me të u kam folur shokëve të rinj,
u kam bërë zë zogjve në hapësirë
e të gjithë, të gjithë më janë bërë më intimë.

Kam marrë sytë, sytë e tu të bukur
(tek zbukurohet fusha e nuse bëhen vajzat
në dasma)
në udhët e reja ku më ecën dita.

E para bukurisë së saj jam mrekulluar si në
ëndrra,
veten e kam ndier fëmijë, sërish kam thënë:
«U rrita!».

Kam marrë gjithçka tënden, vendlindja ime,
(pa harruar ëndrrat e tua)
që nga ajri që thith e gjer tek kokrrizat e
dheut.
Tani në gjithë qenien time, në trup e në shpirt
ndiej se rritem tok me Atdheun...

Ruaju!

Kthehesha nga fshati në ditët e verës.
Rruja me pluhur, këpucët me pluhur.
E ti sikur harron, sikur, s'ke kohë
t'i bësh me bojë.

Ku të lë puna të merresh me to!
O, po kjo është fyerje për njeriun e punës!
Prandaj jam zemëruar,

shumë jam zemëruar.

Ditëve në vjeshtë tek kthehesha në qytet
mbi çizmet e verdha, të bukura
të kam parë baltë,
se ti prapë do t'u thuash njerëzve se puna...
Prandaj në shpirt kam ndier zbrazësirë,
neveri, kam ndier, ta dish!

Se e di që je grindur me rrugën,
nga qyteti në fshat,
nga fshati në qytet
baltën e saj ke sharë.

Ruaju!

Se do ta marrë vesh toka lodrën tënde...
E toka s'të fal!

Në maj

Ecnim nën shiun e bukur të majit,
nën shiun pikëmadh unë dhe ti.
Dhe njerëzit nga ballkonet na shihnin
dhe qeshnin me ne të dy.

C'ylber të bukur krijonte atë ditë
shiu që binte dhe dielli i syve tanë!
Po sikur njerëzit të mos qeshnin aq çiltër,
patjetër ylberi do të zhdukej në çast...

Si tē mos e dua tokën?!

Ditë vjeshte ish.

Clodhem i pak, tha nëna.

E u ulëm mbi ugar.

Dhe, ndoshta, kënga e zogjve,
fjalët e tokës si një ninullë

i zbritën nënës gjumin në qepallë.

Fryu një fllad i lehtë.

Flokët e nënës, flokët e bardhë,
mbi dheun e vlagët

njëqindfish më tē bukur më ngjanë.

I ngazëllyer

shtrëngova një grusht dhé
e vetvetes i fola me zë:

Si tē mos e dua tokën?!

Nëna ime u thinj me të...

Nderim për njeriun e mirë

Erdhi vdekja dhe t'i mbylli sytë;
në vlugun e punëve s'ngrihesh dot.
Shtrirë në mesin e dhomës ti,
i palodhuri i arave.

Askush s'ishte i tepërt në vdekjen tënde,
të dashurit e tu, shokët e miqtë,
bujqit e fshatrave më të skajshëm
që të kishin dëgjuar vetëm emrin e mirë.
Bile as njeriu që kaloi rastësisht
dhe mori vesh për vdekjen tënde.
Asnjëri prej tyre s'ishte i tepërt,
sepse nga ardhja e tyre
vdekja iku larg, deri në mosqenie.

Qyteza e minatorëve

E pagjumë mëngjeseve dhe në mesnatë,
si çdo qytezë minatore, qyteza ime.
Sa bie mbrëmja e merr diellin në gjoks
minatorëve t'u ndrijë rrugën galerive...

Bashkë me agun e ditës së re

Ndalet urbani.
Dikush hipën,
dikush zbrejt;
gjallërohet rruga...

Ndalet këtu
të hipin punëtorët e gurores
dhe pak më tutje
të zgresë kjo vajzë
që e presin fëmijët në shkollën e fshatit...

Vrapon peizazhi i blertë
mes qeshjes së ditës së re.

Dikush ka harruar në autobus
një tufë luleshqerra
dhe shoferi qesh:
Paska ardhur pranvera!..

Kështu hipin e zbresin njerëzit
me buisjen e stinës që vjen,
me të përditshmet fjalë:
«Mirëmëngjes!
Mirupafshim!
Punë të mbarë!»

Kështu shumohen stacionet,
siç shumohetjeta.
Pranë stacioneve të përditshme,
pa tabela,
shfaqen njerëzit
bashkë me agun e ditës së re...

Në themele

E dogjën dhe e gjakosën Borovën.
Shtëpitë e djegura
të gjitha u shembën.

«T'i ndërtojmë, — thanë borovarët, —
të reja shtëpitë!
Në themele të tyre të vëmë
gurë të nxeh të,
gurë të gjakosur
që shtëpitë tonë
të mos e harrojnë kurrë urejtjen!»

U bënë vite

Letër nënës

U bënë vite, nënë.

Të ashpra duart si duart e shokëve,
si duart e tua me kallo janë.

Po ti mos u çudit pse në këtë letër
për herë të parë për duart të flas.

Si të ta them, si?

Më mirë kështu, hapur,
më mirë kështu, ciltër.

U bënë vite, nënë! Qytezën e vogël në krahë
malesh

si shtëpinë time e kam tanë.

Veç letrat e shpeshta,
letrat e shpeshta që dërgon ti
sikur më ndajnë nga shokët..

E rri e mendoj si këtë pasmesnate
se më mungon diçka
që s'e kam unë,
s'e ke edhe ti.

Hapur nënë!

Çiltër nënë!

O nënë, nëna ime e mirë,
sikur ta dinin gishtérinjtë e tu,
gishtérinjtë e buhavitur nga vitet e puna,
sikur ta dinin se para shokëve skuqem
kaq shumë letra s'do të shkruanin.

Pranë detit

I lodhur
zbrita në një qytet në bregdet.
Fryu erë.
Deti më thirri
pa kuptuar
brigjeve të tij;
gjer në mbrëmje u enda
dhe lodhjá si një pulëbardhë e vonuar
tutje detit iku fluturim...

Fund vjeshte

Duke iku

vjeshta

penelatat e fundit hedh në rrugë.

Mbi pemët, në sfondin gri
gjithçka u rikrijua si dikur:

Tani në rrugë ecën një vajzë që kam dashur;
mbi supe i ulen fletët e zverdhura,
fletët e blireve, fletët e plepave
ku unë kam shkruar fjalë
dhe inicialet e emrit tim
dhjetë vjet më parë...

Kjo vajzë që ikën çdo fund vjeshte
me të qeshurën e çiltër që kumbon në rrugë
tretet, zvogëlohet... në çast
humbet ashtu si një yll në hapësirën blu,
në vjeshtën e ardhshme
imazhi i saj
për t'u shfaqur prapë...

Shënim

Albert Rakipi ka lindur më 1961 në Bar-mash të rrethit të Kolonjës. Ka mbaruar studimet e larta për gjuhë-letërsi. Boton poezi herë pas here në organet e shtypit. Ky është libri i parë.

P E R M B A J T J A

Nënat e dëshmorëve	3
Barrikada	5
Zogu i marsit	6
Në autobusin e orës gjashtë	8
Demetra	10
Dita ka emrin tënd	11
Meditim në ditën e 8 Nëntorit	12
A e di?	14
Pylli mat moshën time	16
Memeja	17
E pamundur!	18
Reportazh nga festa e bukës së re	20
E diel vjeshtë në Tiranë	21
Kur përcillem me nënën	23
E sinqertë	24
Kujtimi	25
Dy ditë nga mungesa e nënës	27
Kur ndahem prej teje	29
Një shekull dëshmor	30
Nesër nisem pér në jug	31
Vizitë e nxënësve të klasës së parë në varrezat e dëshmorëve	32
Prag vere	34

Në zyrën e vogël të PT-së në fshat	36
Moshatarja	38
Të ka parë në ëndërr nëna	40
Këngë dashurie për vendlindjen	41
Gjyshja ime mbjell borzilok	43
Më iku vera pa një varg të ri	45
Inspektori	46
Ikën prej meje një fëmijë	48
Atdheu	50
Ruaju!	52
Në maj	53
Si të mos e dua tokën?!	54
Nderim për njeriun e mirë	55
Qyteza e minatorëve	56
Bashkë me agun e ditës së re	57
Në themele	59
U bënë vite	60
Pranë detit	62
Fund vjeshte	63

ES-4001 0002 0001 0001
 0001 0001 0001 0001 0001
 0001 0001 0001 0001 0001